



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

.Numri i lëndës: 2022:196761
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05800717

K.DH.SH.II.nr.842/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi” SH.A, me seli në rr. “Bill Clinton” p.n., në Prishtinë, kundër debitorit TV Kabashi, me seli në Gllogoc, i përfaqësuar nga Rrahim Hajdari, avokat në Gllogoc, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 2090/23 të datës 27.12.2023, me datën 10.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit “Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi” SH.A., me seli në rr. “Bill Clinton” p.n., në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 2090/23 të datës 27.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 2090/23 të datës 27.12.2023, e ka pranuar si të bazuar propësimin e debitorit “TV Kabashi, me seli në Gllogoc, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 1488/18, i lejuar më datë 12.11.2018, nga Përmbaruesi Privat Irfan I Kerçagu, Shfuqizohet,

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë,

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit, P.nr. 1488/18, i lejuar më datë 12.18.2018, me të cilin ka lejuar përmbaremore me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori TV Kabashi, me seli në Glllogoc, që për periudhën prej 01.01.2014 deri më 31.10.2018, të paguaj borxhin kryesor për shfrytëzimin e shërbimeve të mbeturinave në shumën prej 1,269.66 €, me kamatë prej 8% nga dita e lejimit të përmbaremore dhe deri në pagesën definitive dhe shpenzimet përmbaremore, me ndalimin e mjeteve monetare të cila i ka debitori në llogaritë bankare, me ndalimin e mjeteve në të ardhurat personale, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit, deri në vlerën e borxhi.

Propozimin për përmbaremore e kishte bazuar në kartelën Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr. 7973 –, nga periudha kohore 01.01.2014 deri 31.10.2018, të lëshuara nga Kreditori (këtu e tutje Ekstrakti), të cilin në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit.

Kundër urdhrin përmbaremore debitori ka paraqitur prapësimin brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të tij, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaremore duke theksuar ndër të tjerash se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, për faktin se kreditori që nga viti 2005 nuk ka ardhur asnjëherë për të marrë mbeturinat dhe as nuk ka sjellë asnjë faturë për pagesë në emër të bartjes së këtyre mbeturinave. Më tutje ka shtuar se borxhi në fjalë është parashkruar dhe atë duke u

bazuar në nenin 360 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). I ka propozuar gjykatës që ta abrogojë urdhrin për përmbartim. Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit duke theksuar se nuk ka pasur asnjëherë ndonjë njoftim, shkresë, kërkesë ose ankesë për njoftimin rreth mungesës së shërbimeve që nuk i janë kryer debitorit, ashtu që barra e provës ka qenë mbi debitorin. Në fund ka deklaruar se është fakt i ditur se kreditori është e vetmja ndërmarrje publike e pajisur me autorizime shtetërore për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së higjienës publike. I ka propozuar gjykatës që kundërshtimet e debitorit të refuzohen në tërësi si të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim: Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist Nr. 7973, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata e shkallës e parë vlerëson se Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr. 7973, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit/kartelës së konsumatorit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitorit.

Tutje kjo Gjykatë deri të ky vlerësim erdhi pasi që Kartela e Konsumatorit, me Nr. 7973-Ekstrakti, përmban borxhin në shumën prej 1,269.66 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2014 deri me datën 31.10.2018, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti gjendja fillestare fillon nga shuma 969.16€ dhe në përshkrimin e saj ceket të mbartura, andaj nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri tek borxhi i kërkuar, andaj si rrjedhojë ky dokument nuk

pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qarte se si dokument i besueshëm - kartela financiare e kontabilitet nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore të LPP-së, sepse borxhi i cili rezulton në shumën prej 1,269.66 € është kërkuar për periudhën kohore nga 01.01.2014 deri me datën 31.10.2018, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti gjendja fillestare fillon nga shuma 969.16€ dhe në përshkrimin e saj ceket të mbartura, andaj nuk mund të vërtetohet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Andaj gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më te drejt gjykata e shkalles se parë ka vlerësuar se kreditori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme në mbështetje te pretendimeve te tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr.842/24, me datë 10.06.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti